



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**Shtojca 14.**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Data 05/05/2026

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE)  ose**

“STELLA” Shpk, me Nuis J87603505T dhe me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe- Shkoder km 1-re, ne zonen kadastrale 8632, Nr. pasurie 13/55-1, volum 24 faqe 225, Lezhe.

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)**

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO  JO**

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO  JO**

Tipi i Kontratës: Mallra.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur, mbi kufirin e larte monetar.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-77845-03-02-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale per mirembajtjen e rrugeve, trotuareve, shesheve, sistemit ujites dhe kullues ne Bashkine Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes Kuader.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 22/04/2026.

<sup>1</sup>Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 29, datë 27 Prill 2026.

### **KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

- 1- Operatori ekonomik “MURATI D” SH.P.K, me Nuis K42003004T dhe me oferte ekonomike 37,723,609 (tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e nente) Lek pa TVSH,  
- OE/BOE me nënkontraktor  
PO  JO X
- 2- Operatori Ekonomik “GENERAL TRADING” SH.P.K me Nuis M21501011F dhe me oferte ekonomike 40,641,303 (dyzet milion e gjashtëqind e dyzet e një mijë e treqind e tre) Lek pa TVSH,  
- OE/BOE me nënkontraktor  
PO  JO X
- 3- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, me Nuis J87603505T dhe me oferte ekonomike 42,248,821 (dyzet e dy milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e njëzet e një) Lek pa TVSH,  
- OE/BOE me nënkontraktor  
PO  JO X

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

### **Operatori Ekonomik “MURATI D” SH.P.K me Nuis K42003004T,**

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ploteson piken 2.3.4, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar për mallrat sipas tabelës së mëposhtem:*

1. *Per Materialet Elektrike*
2. *Per Hekurin*
3. *Per Bordura betoni dhe Pllaka Trotuari*

---

<sup>1</sup> Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

#### 4. Per Çimento

5. Per asfaltobetonin e ftohte

6. Per Bojrat

7. Per Kosha mbajtës guri me rrjete Çeliku i zinkuar (gabion)

Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, per materialet e sipercituara”.

Nga analizimi i Dokumentave standarte te tenderit verehet se per vendosjen e ketij kriteri Autoriteti Kontraktor eshte bazuar ne zerat e preventivit qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit duke vleresuar si te nevojshme qe mallrat te furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar, kjo ne perputhje me kerkesat ligjore te parashikuara ne pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe ne VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper, KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri OE-te ne rast se **nuk jane prodhues** duhet te paraqesin per mallrat e mesiperme, **kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar.**

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se operatori ekonomik ka paraqitur ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike per “**Çimento dhe Hekur**”, Autorizim Distributori nga Subjekti “SHIJAKU“ SH.P.K, ku autorizon si me poshte vijon:

## **AUTORIZIM DISTRIBUTORI**

**SHOQËRIA JONË AUTORIZON SHOQËRINË: “MURATI D” SHPK ME ADRESË:  
RRUGA E KAVAJËS, ISH KOMBINATI USHQIMOR, GODINA 1-KATËSHE, TIRANË; E  
NIPT K42003004T ME ADMINISTRATOR DERVISH MURATI**

**Të marrë pjesë në tenderin me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, sistemit ujitës dhe kullues në Bashkinë Lezhë”, me nr. reference REF-77845-03-02-2026 që organizon Bashkia Lezhë më datë 02.04.2026 ora 10:00**

**1. Shoqëria jonë e autorizon shoqërinë e mësipërme: Për çimento dhe hekur**

KVO thekson se nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se Subjekti “SHIJAKU” SH.P.K duke mos qene prodhues ka leshuar per OE “MURATI D” SH.PK Autorizim Distributori per materialet “**Çimento dhe Hekur**”, por nga verifikimi ne SPE rezulton se ka bashkengjitur vetem “Deklarate partneriteti me Grupin SIDENOR si prodhues celiku” dhe “Autorizim Prodhuesi per hekur me KURUM INTERNATIONAL SHA”.

KVO veren se per “Çimento” nuk eshte paraqitur asnje autorizim/ akt marrëveshje ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis ndonje prodhuesi Çimento dhe Subjektit “SHIJAKU” SH.P.K si distributor duke mos permushur kerkesen se per autorizimet e distributorit duhet te paraqitet dokumentacion qe provon lidhjen me prodhuesin.

Per sa parashturam me lart, sjellim ne vemendje se edhe **Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 825/2021**, gjykon se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu **KPP** ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne **vendimin Nr. 604/2019**, ne te cilin thekson se : -**“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”**

-**“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.**

Sa me sipër duke qene se nuk ka paraqitur per furnizuesin (SHIJAKU SH.P.K) autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis tij dhe ndonje prodhuesi per “Çimento” ky kriter konsiderohet i papermbushur.

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.8, ku parashikohet se “Ditën dhe oren e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Tub HDPE SN8 d= 315mm ( i brinjëzuar)	ml	1
2	Pllaka trotuari 6 cm	cope	1
3	Pllaka betoni (Kapak) permasa 70 X 55 X 5 cm	cope	1
4	Bojë e bardhë termoplastike	Kg/sipas paketimit	1
5	Ndriçues rrugor Led 100 w	cope	1
6	Spot katror LED, 24 W, 4000K, 220V-240V AC 30 x 30 cm (me suport)	cope	1

7	Led	ml	1
---	-----	----	---

- *Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave sipas DST-se, pranë magazines se Drejtorise se sherbimeve Publike, te Bashkise Lezhe me adrese: Rruga Vellezrit Coku, Ish SMT, Lezhe.*
- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.*
- *Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.*

KVO thekson se per te permbushr kete kriter operatoret ekonomike duhet te paraqesin nga nje moster per secilin artikull te kerkuar ne tabelen e mesiperme dhe mostrat te jene **ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.**

KVO veren se Operatori Ekonomik ka paraqitur mostrat prane Bashkise Lezhe ku rezulton se për artikullin **“Ndriçues rrugor Led 100 w”**, ka dorëzuar mostrën në mospërputhje të plotë pasi nuk është sipas specifikimeve teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar specifikimeve teknike për artikullin **“Ndriçues rrugor Led 100 w”**, rezulton se është kërkuar shprehimisht minimumi” Lloji i ndriçimit: i bardhë i ftohtë **4200K**. Lloji i llampave: LED, tipi: Ndriçues rruge, Jetëgjatësia: 50000 Hrs. Gjerësia: 23.7 cm Gjatesia: 68 cm . Fuqia: 100W. Përfshihen Llambat: Po. Thellësia: 9.2 cm. **Materjal: Metal /Xham**. Shkalla e mbrojtjes: IP65

Nga verifikimi i mostres për artikullin **“Ndriçues rrugor Led 100 w”**, te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se nuk është ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara ne DST, pasi operatori ekonomik ka dorëzuar mostër: **“Ndriçues 4000K, Materjal: Plastik /Xham etj”** si me poshte te pasqyruar ne foto.





-Përsa konstatuar produkti mostër për “Ndricues rrugor Led 100 w” nuk përmbush specifikimet teknike.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave thekson faktin se qëllimi i Autoritetit Kontraktor për paraqitje të mostrave është nëse ato përmbushin specifikimet teknike me të dhënat që përmbajnë artikujt objekt prokurimi në tërësi dhe ato të kërkuara për mostra në veçanti, në përputhje me nenin 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

KVO rithekson se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre sipas kërkesave dhe kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato.

Operatori ekonomik ofertues nuk ka përmbushur kërkesat minimale siç janë përputhja e të dhënave të kërkuara në DST për artikujt që do të ofertojë, ndaj dhe të dhënat që përmbajnë artikujt paraqitur si mostra duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike.

Akoma më tej KVO sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me Dokumentet e tenderit dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

KVO thekson se te njejtin qendrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 1428/2025 ku nder te tjera gjykon se:

***“III.1.7 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.***

.....Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë

***ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.***

*III.1.8. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit, rezulton se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar në tabelën përkatëse, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave të përcaktuar në dokumentat e tenderit pranë zyrës së Protokoll- Arkiv pranë Bashkisë.....*

*.....Për Art. 45. Letër rolo për duar me prerje, ngjyre e bardhë (800gr). Operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se, Letër kuzhine Rolo për duart, e bardhë, pesha 450 gr + 5%, **-Përsa konstatuar produkti mostër për art.45 nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket peshës së kërkuar.***

*.....Në përfundim të konstatimit të fakteve Komisioni gjykon se operatori ekonomik “S... M...” P.F nuk plotëson kriteret për kualifikim, në lidhje me paraqitjen e mostrave në përputhje me specifikimet teknike në këtë procedurë”.*

Sa me sipër duke qenë se Operatori Ekonomik nuk plotëson kriteret për kualifikim, në lidhje me paraqitjen e mostrave në përputhje me specifikimet teknike ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “MURATI D” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “MURATI D” SH.P.K me Nuis K42003004T, skualifikohet.**

## **II. Operatori Ekonomik “GENERAL TRADING” SH.P.K me Nuis M21501011F,**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 2.3.3, ku parashikohet se *“Operatori ekonomik duhet te disponojë:*

*-1 (nje) mjet transporti me kapacitet mbajtes nga 1 deri ne 3.5 ton,*

*-1 (nje) autovinc,*

*-1 (nje) kamion veteshkarkues, me kapacitet mbajtes mbi 10 ton,*

*në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi për transportin e mallrave deri në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.*

- *Per te provuar disponimin e mjeteve te kërkua, OE duhet te paraqese:*

*a- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, siguracion, taksa, pronesia).*

*b- Per te konfirmuar disponibilitetin e mjetit te marre me qira ose kontrate bashkepunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm duhet te paraqiten edhe Kontrate e qirase/ Kontrate Bashkepunimi.*

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te deklarojne ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit mjetet qe dsiponojne.

Nga verifikimi i Formularit te Vetedeklarimit rezulton se Operatori Ekonomik ofertues ka deklaruar mbeshtetje te kapaciteteve ne subjektin “RAFIN COMPANY” SH.P.K per te gjithë kriterin 2.3.3, si me poshte vijon:

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>
Shoqëria “RAFIN COMPANY” SHPK	L52125110A	Kapacitetet njerëzore:  Makineri dhe mjete:	- 2 punonjës  1- Mjet transporti me kapacitet mbajtës nga 1 deri në 3.5 ton- me targë AA841YG- në pronësi. 2- Autovinç – me targë AB684NV- në pronësi 3- Kamion vetshkarkues, me kapacitet mbajtës mbi 10 ton – me targë AB325DJ- në pronësi

KVO, mban ne kosiderate se ne nenin 90/2, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
- **Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.**

Theksojme se neni 90/2, i VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ka parashikuar mundesine e mbeshtetjese ne kapacitetet e subjekteve te tjera por ne cdo rast operatoret ekonomike duhet të provojnë se plotësojnë të paktën **50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.**

Sa u konstatua me siper, Komisioni i Vleresimit te Ofertave thekson se operatori ekonomik nuk disponon asnje mjet sipas kerkesave te kriterit 2.3.3, te DST-se, dhe rrjedhimisht nuk **permbush të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor per kriterin 2.3.3 ne lidhje me disponimin e mjeteve.**

Si perfundim, operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne kriterin 2.3.3, te DST-se per disponimin e mjeteve te kerkuara, pasi nuk permbush kriterin ligjor per plotesimin e të **paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.**

**Se dyti**, nuk ploteson pikën 2.3.4, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar për mallrat sipas tabelës së mëposhtme:*

1. *Per Materialet Elektrike*
2. *Per Hekurin*
3. *Per Bordura betoni dhe Pllaka Trotuari*
4. **Per Çimento**
5. *Per asfaltobetonin e ftohte*
6. *Per Bojrat*
7. *Per Kosha mbajtës guri me rrjete Çeliku i zinkuar (gabion)*

*Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, për materialet e sipercituara”.*

Nga analizimi i Dokumentave standarte të tenderit vërehet se për vendosjen e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar në zërat e preventivit që do të realizohen dhe rendesise të vecante të objektit të prokurimit duke vlerësuar si të nevojshme që mallrat të furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar, kjo në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuar me siper, KVO vëren se për përmbushjen e këtij kriteri OE-te në rast se ***nuk janë prodhues*** duhet të paraqesin për mallrat e mesipërme, ***kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar***.

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për **“Çimento”** asnjë dokumentacion apo Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar që provon se operatori ekonomik ka lidhur për furnizimin e tij për këto mall.

KVO vëren se për **“Çimento”** nuk është paraqitur asnjë autorizim/ akt marrëveshje ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis Operatorit Ekonomik ofertues dhe ndonjë prodhuesi Çimento apo distributori zyrtar duke mos përmbushur këto kriter.

Po ashtu, KVO vëren se ky Operator Ekonomik ofertues nuk rezulton të jetë prodhues për **“Çimento”**, pasi bazuar në verifikimet në [qkb.gov.al](http://qkb.gov.al) nuk disponon leje mjedisore si prodhues.

Për sa parashturam më lart, sjellim në vëmendje se edhe **Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin Nr. 825/2021**, gjykon se për të përmbushur qëllimin e vendosjes së kriterit duhet të

parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu **KPP** ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne **vendimin Nr. 604/2019**, ne te cilin thekson se : - **“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”**

-**“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.**

Sa me sipër duke qenë se nuk ka paraqitur autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe ndonjë prodhuesi apo distributori për **“Çimento”** ky kriter konsiderohet i papërbushur.

**Se treti**, nuk plotëson kriterin 2.3.8, ku parashikohet se **“Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:**

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Tub HDPE SN8 d= 315mm ( i brinjëzuar)	ml	1
2	Pllaka trotuari 6 cm	cope	1
3	Pllaka betoni (Kapak) permasa 70 X 55 X 5 cm	cope	1
4	Bojë e bardhë termoplastike	Kg/sipas paketimit	1
5	<b>Ndriçues rrugor Led 100 w</b>	cope	1
6	Spot katror LED, 24 W, 4000K, 220V-240V AC 30 x 30 cm (me suport)	cope	1
7	Led	ml	1

- **Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave sipas DST-se, pranë magazines se Drejtorise se sherbimeve Publike, te Bashkise Lezhe me adrese: Rruga Vellezrit Coku, Ish SMT, Lezhe.**
- **Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.**
- **Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.**

KVO thekson se për të përmbushur këto kriter operatoret ekonomike duhet të paraqesin nga një mostër për secilin artikull të kërkuar në tabelën e mësipërme dhe mostrat të jenë **ne përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.**

KVO verën se Operatori Ekonomik ka paraqitur mostrat pranë Bashkisë Lezhë ku rezultoi se për artikullin **“Ndriçues rrugor Led 100 w”** ka dorëzuar mostrën në mospërputhje të plotë pasi nuk është sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar specifikimeve teknike për artikullin **“Ndriçues rrugor Led 100 w”**, rezultoi se është kërkuar shprehimisht minimumi” Lloji i ndriçimit: i bardhë i ftohtë **4200K**. Lloji i llampave: LED, tipi: Ndriçues rrugor, Jetëgjatësia: 50000 Hrs. Gjerësia: 23.7 cm, Gjatesia: 68 cm. Fuqia: 100W, Përfshihen Llambat: Po. Thellësia: 9.2 cm. Materjal: **Metal /Xham**. Shkalla e mbrojtjes: IP65

Nga verifikimi i mostres për artikullin **“Ndriçues rrugor Led 100 w”** të paraqitur pranë Bashkisë Lezhë rezultoi se nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST, pasi operatori ekonomik ka dorëzuar mostër: **“Ndriçues 4000K, Materjal: Plastik /Xham etj”** si më poshtë të pasqyruar në foto.





-Përsa konstatuar produkti mostër për “Ndricues rrugor Led 100 w” nuk përmbush specifikimet teknike.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave thekson faktin se qëllimi i Autoritetit Kontraktor për paraqitje të mostrave është nëse ato përmbushin specifikimet teknike me të dhënat që përmbajnë artikujt objekt prokurimi në tërësi dhe ato të kërkuara për mostra në veçanti, në përputhje me nenin 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

KVO rithekson se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre sipas kërkesave dhe kritereve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato.

Operatori ekonomik ofertues nuk ka përmbushur kërkesat minimale siç janë përputhja e të dhënave të kërkuara në DST për artikujt që do të ofertojë, ndaj dhe të dhënat që përmbajnë artikujt paraqitur si mostra duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike.

Akoma më tej KVO sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me Dokumentet e tenderit dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

KVO thekson se të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 1428/2025 ku ndër të tjera gjykon se:

*“III.1.7 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se **kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.***

*.....Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.*

III.1.8. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit, rezulton se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar në tabelën përkatëse, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave të përcaktuar në dokumentat e tenderit pranë zyrës së Protokoll- Arkiv pranë Bashkisë.....

.....Për Art. 45. Letër rolo për duar me prerje, ngjyre e bardhë (800gr). Operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se, Letër kuzhine Rolo për duart, e bardhë, pesha 450 gr + 5%, **-Përsa konstatuar produkti mostër për art.45 nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket peshës së kërkuar.**

.....Në përfundim të konstatimit të fakteve Komisioni gjykon se operatori ekonomik “S... M...” P.F nuk plotëson kriteret për kualifikim, në lidhje me paraqitjen e mostrave në përputhje me specifikimet teknike në këtë procedurë”.

Sa me sipër duke qenë se Operatori Ekonomik nuk plotëson kriteret për kualifikim, në lidhje me paraqitjen e mostrave në përputhje me specifikimet teknike ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “GENERAL TRADING” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të veçanta kualifikuese.

**Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “GENERAL TRADING” SH.P.K me Nuis M21501011F, skualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, me Nuis J87603505T dhe me oferte ekonomike 42,248,821 (dyzet e dy milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e njëzet e një) Lek pa TVSH,

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek zyra e protokollit te Bashkise Lezhe brenda 10 (dhjete) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO  JO

Nëse Po ( Nr. \_\_ Datë \_\_ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**